

RËNDËSIA E RREGULLIMIT TË RADHËVE (SAFËVE) GJATË NAMAZIT

(Behxhet Jashari)
behxhet_jashari@hotmail.com

“Namazi, qoftë të kryhet individualisht ose në xhematë, është shprehje e zjarrtë e dëshirës të cilën njeriu e ndjen në vete që të pranojë përgjigje në qetësinë e tmerrshme të Gjithësisë”.
(Muhammed Ikbāl)

Namazi si shtyllë e fesë, të cilën si të tillë e vërteton edhe thënia e Muhammedit a.s., ku thotë: *“Namazi është shtyllë e fesë”*, përbëhet prej dy anëve kryesore; prej formës (ana e jashtme) dhe nga ajo e brendshme, e quajtur hushu'a, e cila përjetohet varësisht prej gjendjes psikofizike të atij që kryen faljen (namazin) - musaliut dhe dorëzimit në momentet gjatë të folurit me Allahun.

Formimi i safëve (radhëve) është ana formale e kompozimit të namazit në xhemat (bashkësi). Forma në namaz është e domosdoshme. Mirëpo edhe pse ekziston një lidhshmëri në brendinë e qenies së besimtarit, këtë formë shpeshherë e pranojmë vetëm në mënyrë sipërfaqësore. Krahas kushteve tjera dhe pjesëve përbërëse të namazit të cilat janë të domosdoshme për vlefshmërinë e vet namazit, edhe rregullimi i safëve gjatë kryerjes së këtij obligimi (të falurit) në xhemat (bashkësi), poashtu bën pjesë në vlefshmërinë dhe bukurinë e namazit. Në rastet kur namazi bëhet në xhemat, çdo besimtarë duhet të dijë dhe të ketë kujdes edhe rreth rregullimit dhe drejtimit të safëve (radhëve), sepse me drejtimin dhe rregullimin e safëve, namazit i jepet një pamje dhe harmoni e jashtme më e bukur. Ebu Hurejre r.a. përcjell se Muhammedi a.s. ka thënë: *“Rregulloni safët në namaz, sepse safët e rregulluara në namaz janë pjesë e bukurisë së namazit”*.

Siç kuptohet, rregullimi i safëve gjatë namazit simbolizon kompaktësinë, bashkimin dhe lidhshmërinë vëllazërore të atij xhemati (bashkësie) që gjendet në namaz sepse “qëllimi i vërtetë i namazit arrihet me kryerjen e tij në xhemat. Xhemati (bashkësia) është

bashkim i njerëzve të entuziazmuar me pretendime të njëjta, të cilët i përqëndrohen qëllimit unitar dhe në ndërgjegjen e tyre i orientohen aksionit të nxitjes së veçantë”¹. Nëse një besimtar, i cili me rastin e formimit të safëve për në namaz, mundohet t'i rregullojë dhe plotësojë safët siç duhet, ai faktikisht ka kuptuar porosinë dhe praktikën e Muhammedit a.s. Kurse çrregullimi i safëve gjithsesi është pasqyrë e moskujdesit të pjesëmarrësve në namaz dhe mosnjohjes së vlerave praktike dhe vetë sunnetit (praktikës) të Muhammedit a.s.

Rregullimi i safëve në praktikë

Nëse i bëjmë një vështrim mjediseve tona se sa praktikohen porosinë e Muhammedit a.s. rreth rregullimit të safëve, do të shohim se rrallëherë praktikohet, që ndonjëri nga imamët e xhamive të kthehet kah xhemati, t'ua tërheqë vërejtjen dhe t'i këshillojë ata mbi drejtimin dhe rregullimin e safëve. Imam Buhariu përcjell hadithin prej Enes ibn Malikut r.a. i cili thotë: *“Pasi që u lexua ikameti për namaz, Muhammedi a.s. u kthye me fytyrë kah ne dhe tha: “Rregulloni safët tuaja dhe shtrëngoni mirë njëri tjetrin! Unë ju shoh edhe pas shpine”*.

Kjo praktikë e bukur e Muhammedit a.s. për fat të keq shumë rrallë praktikohet, që do të thotë se këto urdhëra apo këshilla ende nuk i kemi kuptuar siç duhet. Për këtë çështje, është me rëndësi të theksojmë mendimet e disa dijetarëve më të shkëlqyeshëm klasikë. Sipas mendimit të Imam Ebu Hanifes, Shafiut dhe Malikut, radhitja e safëve është sunnet, kurse disa të tjerë këtë rregull e klasifikojnë në vaxhib (detyrë e obliguar). Imam ibn Hazëm vërteton se radhitja e safëve është detyrë e obliguar e kategorisë së parë - farz. Ibn Hazëm përcjell prej Jezid ibn Malikut se ajeti kur'anor në suren (kaptinën) Saffat, 165; *“Edhe ne jemi të rreshtuar”*, është shpallur për arsye se në fillim as'habët e Muhammedit a.s. gjatë namazit nuk radhiteshin në safë (radhë). Pas shpalljes së këtij ajeti, Muhammedi a.s. i urdhëroi besimtarët që namazi (falja) të kryhet në safe.

Në një hadith Muhammedi a.s. thotë:

“Ose do t'i rregulloni safët tuaja në namaz, ose Allahu do t'i mbrapshtojë fytyrat tuaja prapa”.

(Transmeton Buhariu)

1 IKBAL, Muhammed, 'Obnova vjerske misli u islamu', f. 72, Sarajevë 1979.

Ibn Hibbani në Sahihun e tij tregon se në një rast Muhammedi a.s. u tha shokëve të tij: “Shtrëngoni radhët (safët), afrohuni njëri tjetrit dhe barazoni shpatullat dhe qafat tuaja, për Allahun unë shoh djallin (shejtanin) si një qengj i zi që futet nëpërmjet zbrazëtirave të safëve në mesin tuaj”.

Ebu Hurejre r.a. ka thënë: “Shoku im (Muhammedi a.s.) më ka porositur tri gjëra lidhur me namazin; sexhden dhe rukunë mos t’i bëj sikurse pula kur i mbledh kokrrat, mos t’i lëshoj duart (në sexhde) si qeni dhe mos të vështroj gjatë namazit sikurse dhelpëra”.

Xhabir ibn Semure r.a. thotë: Muhammedi a.s. doli në mes nesh dhe tha: “Pse nuk po i mbushni safët (radhët), ashtu sikurse radhiten melekët te Krijuesi i tyre?”

Ne i thamë: “O I Dërguar i Allahut, po si radhiten melekët në safë para Krijuesit të tyre?” Muhammedi a.s. tha: “*I mbushin safët e parë dhe i ngushtojnë safët në mes tyre*”. (Transmeton Muslimi).

Ebu Hurejre r.a. thotë se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Safi më i mirë te meshkujt është safi i parë, ndërsa safi më i keq te ta është safi i fundit. Ndërsa safi më i mirë te femrat është safi i fundit, kurse më i keqi është safi i parë”. (Transmeton Muslimi).

Nga Enesi r.a. transmetohet se Muhammedi a.s. ka thënë: “*Plotësoni safin e parë, pastaj atë që vijon. Nëse duhet të ketë zbrazëtirë, le të jetë zbrazëtira në safin e fundit*”. (Ebu Davud).

Ebu Davudi në përmbledhjen e tij të haditheve transmeton se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Drejtoni safët dhe shpatullat tuaja, plotësoni zbrazëtirat në radhët e para, bashkohuni njëri me tjetrin dhe mos i lejoni vend shejtanit në safët tuaja. Kush e plotëson radhën e ndërprerë, Allahu do ta bashkojë me mëshirën e Tij, kush e ndërpreu safin, Allahu do ta ndërpreu mëshirën e Tij ndaj atij besimtari i cili e ndërpreu safin”.

Siç kuptohet nga hadithet e lartpërmendura, besimtari i cili gjendet në namaz me xhemat, doemos duhet t’i rregullojë radhët ashtu siç ka porositur i Dërguari a.s. Pa dyshim, edhe imamët e kanë për detyrë që para se të fillojë namazi, të kthehen kah xhemati dhe t’i porosisin ata mbi drejtimin dhe

rregullimin e safëve. Ata të cilët faljen e kryejnë me imam, janë të detyruar që gjatë namazit ta përcjellin imamin ashtu që mos të nguten para imamit. Mbi këtë ekziston një thënie nga Muhammedi a.s. i cili ka thënë:

“Imami është vendosur që ta përcjellim dhe mos u ngutni para tij. Kur ai të bëjë rukunë, bëni edhe ju, e kur ai të thotë “semiAllahu limen hamideh” ju thuani: “Rabbena lekel hamd”, kur imami të bëjë sexhde, bëni edhe ju, nëse imami namazin e bën ulët, veproni edhe ju ashtu të gjithë së bashku! Rregulloni safët në namaz, sepse safi i rregulluar është pjesë përbërëse e bukurisë së namazit”.

(Transmeton Buhariu prej Ebu Hurejres r.a.)

Në një rast tjetër Muhammedi a.s. ka thënë: “Radhitni safët, se në të vërtetë radhitja e safëve e plotëson namazin”. (Transmeton Muslimi)

Tregohet se Omeri r.a. e kishte obliguar një njeri i cili i rregullonte safët në xhami, kurse namazin e fillonte atëherë kur kuptonte se safët plotësisht ishin të rregulluara. Kështu vepruan edhe Othmani r.a. dhe Aliu r.a. Duhet ditur se radhët formohen menjëherë pas imamit duke filluar nga ana e djathtë ose “nëse safi është i mbushur, atëherë ai i cili bashkangjitet në xhemat do ta tërheqë njërin nga ata që janë duke u falur, duke i dhënë shenjë nga ana e prapme edhe atë duke e prekur me dorë. Kjo bëhet kështu, për arsye se safi nuk mund të fillojë direkt vetëm me një njeri, por formimi i safit fillon me dy njerëz e më tepër, kurse vendin që e lëshon ai i cili është tërhequr prapa mbetet i zbrazët. Nëse ndërkohë ndonjëri ngjitet në safin e posafomuar, atëherë ai i cili është tërhequr prapa, përsëri duhet të kthehet në vendin e zbrazët dhe ta plotësojë atë. Nuk është e lejuar që besimtari të kryejë faljen jashtë safit të formuar, kurse kjo për gruan është e lejuar. Ahmed ibn Maxhxhe përcjell nga Ali ibn Shejban se Muhammedi a.s. e vërejti një njeri i cili kryente namazin jashta safit, dhe u ngrit e qëndroi përderisa ky nuk e mbaroi namazin, e pastaj i tha: “Përgatitu për namaz, sepse nuk vlen namazi i atij i cili kryen namazin jashtë safit”.

Trasmentojnë Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhxhe prej Vasib ibn Ma’bedit se Muhammedi a.s. e vërejti një njeri, i cili ishte duke e kryer namazin i vetmuar pas safit, e në këtë rast ai e urdhëroi që përsëri të kryejë namazin duke i thënë: “*Përsërite namazin*”. Poashtu edhe

Taberaniu në përmbledhjen e tij thekson për të njëjtën çështje. Kështu pra “hadithet e lartpërmendura, të cilët ekspertet e hadithit i konsiderojnë të vërteta, janë argument se namazi i atij që e kryen jashtë safit nuk është në rregull dhe nuk është i pranuar. Ky është edhe mendimi i Imam Ahmed Ibn Hanbeliut, ndërsa imamët tjerë më të njohur konsiderojnë se namazi është në rregull, por i papëlqyer².

Në një rast Muhammedi a.s. ka thënë:

“Barazohuni, radhituni dhe mos e kaloni njëri tjetrin, mos u ndani që të mos u ndahen zemrat. Pas meje le të afrohen të dijsmit dhe të rriturit, pastaj pranë tyre i afërmi dhe prapë pranë tyre i afërmi”.

(Transmeton Muslimi)

Besimtarët janë të obliguar t'i nderojnë dhe realizojnë urdhërat dhe porositë e Muhamedit a.s. Allahu i Lartmadhëruar në Kur'anin Fisnik thotë:

“Ai (Allahu) iu mundëson të bëni vepra të mira, ua shlyen mëkatet tuaja, e kush e respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ka arritur një sukses të madh”. (Ahzabë, 71).

Po ashtu ekzistojnë disa ajete të cilët na obligojnë që t'i respektojmë dhe zbatojmë urdhërat e Muhamedit a.s. Se safët kanë rëndësi të madhe, mjafton të përmendim se dy sure (kaptina) nga Kur'ani e mbajnë atë emër, e ato janë: Sure “Saff” dhe “Saffat”. Në suren “Saff” Allahu flet mbi safët (radhët): “...të rreshtuar si të jetë ndërtesë e fortifikuar”. (Saff,4).

Në suren Saffatë Allahu betohet për safët ku thotë: “Pasha të radhiturit (melekt), që në rreshta (safë) qëndrojnë” (Saffatë, 1).

Nga këto udhëzime kuptojmë se “Islami orienton kah bashkimi, përbuzë ndarjen, admiron xhematin, sepse namazi i cili kryhet në bashkësi është një nga obligimet të cilin Islami e preferon për disiplinë, rend dhe bashkësi”³. Hadithet e lartpërmendura, plotësisht na flasin dhe na tregojnë se kryerja e namazit me xhemat, është një lloj i shfaqjes së parimeve sociale islame të cilat midis tjerash pasqyrohen edhe në formimin e safëve stabil, kompakte dhe të rregulluara. Këto

porosi duhet t'i zbatojmë dhe poashtu edhe të tjerët t'i porosisim që t'i zbatojnë. Le të bëjmë një rishikim në gabimet që bëhen në mjedisin tonë si dhe të mundohemi që namazin tonë ta zbukurojmë duke i rregulluar safët. Me këtë edhe vetë namazit, si shtyllë e besimit, t'i japim një harmoni dhe pamje të bukur.

2 Dr. Jusuf el-Kardavi, “Fetvatë bashkëkohore”.

3 Po aty.